



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)

12.07.2024

Drejtuar: “KASTRATI GROUP” SH.A, me adresë: Lagjia 14, rruga “Tiranës”, ura e “Dajlanit”, Durrës.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-06277-05-23-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse Diesel (Gazoil), me bot”, me afat të marrëveshjes kuadër deri në 3 (tre) vite, me fond limit: 181,689,495 (njëqind e tetëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 1,809,476 (një milion e tetëqind e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 20.05.2024 është 100.41)

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.27, datë 27.05.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “KASTRATI GROUP” SH.A, me NUIS K21711502V, me vlerë të ofruar prej 161 739 922,5 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy presje pesë) lekë pa TVSH dhe normë fitimi 12,9 (dymbëdhjetë presje nëntë) lekë/litër pa tvsh.

2. “RESULI – ER” sh.a, me NUIS L12510413V, me vlerë të ofruar prej 148 492 966 (njëqind e dyzet e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe normë fitimi 7 (shtatë) lekë/litër pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. “RESULI – ER” sh.a, me NUIS L12510413V për arsyet e mëposhtme:
 - Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat formalo-ligjore dhe e përcaktimet në DST për paraqitjen e formularit të ofertës. Konkretisht , “Formulari i ofertës” Shtojca 1/1 e DST dhe “Lista e Cmimeve të Artikujve” Shtojca 2 e DST, nuk janë nënshkruar dhe vulosur në mënyre te rregullt nga subjekti ofertues por janë paraqitur në formën e një “nënshkrimi dhe vule të stampuar” dhe mbivendosur mbi formularin e ofetës. Kjo formë e paraqitjes së ofertës vjen në kundërshtim me përcaktimet e DST ku në fund të shtojcës 1 dhe 2 të DST si dhe paragrafi i fundit i shtojcës 7 të DST **përcaktohet qartë detyrimi i ofertuesit për ta nënshkruar dhe vulosur dokumentin në origjinal.** Citojmë paragrafi i fundit i shtojcës 7 të DST : **“Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuar”**. Praqitja e ofertës me nënshkrim dhe vulë të stampuar e bën dokuemntin të pavlefshme për qëllime kualifikimi dhe oferta refuzohet.
 - Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 3 të Formularit të Ofertës Shtojca 1/1 e DST në lidhje me referencat mbi elementët e cmimit të ofertës. Konkretisht Operatori RESULI-ER sh.a, në dokumentin e paraqitur “Formulari i Listës së Cmimeve të Artikujve” nuk i është referuar cmimit te fundit të Bursës Rojter publikuar nga Buletini i Prokurimeve Publike Nr.32 dt.24.06.2024 per produktin “GAZOIL 10ppm”, por ka deklaruar se i është referuar cmimit të fundit të Bursës Rojter buletinin e Prokurimeve Publike nr. 31 date 18.6.2024. Për sa më sipër OE RESULI-ER nuk plotëson kërkesat e shtojcës 1/1 të DST dhe përcaktimet e pikës 2.1 të Nenit 45 të VKM Nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe për këtë arsye oferta refuzohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. “KASTRATI GROUP” SH.A, me NUIS K21711502V, me vlerë të ofruar prej 161 739 922,5 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e dy presje pesë) lekë pa TVSH dhe normë fitimi 12,9 (dymbëdhjetë presje nëntë) lekë/litër pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

